



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 11.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.11.2020 të parashtruar nga OE "Triangle", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Renovimi i shkollave" Gjin Gazuli dhe "Ahmet Gashi" loti 1** me Nr. të Prok: **616-20-4816-521** dhe numër te brendshëm: **616 20 122 521** nxjerr:

VENDIM

1. **Aprovohet** kërkesa si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE "Triangle" të dt. 10.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Renovimi i shkollave" Gjin Gazuli dhe "Ahmet Gashi" Loti 1**, me Nr. të Prok: **616-20-4816-321** dhe numër te brendshëm **616 20 122 521**.
2. Anullohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për lotin 1, të publikuar me datë: 06/11/2020.

Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë në rivlerësim aktivitetin e prokurimit për këtë lot.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "Triangle" me datë 10.11.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Renovimi i shkollave" Gjin Gazuli dhe "Ahmet Gashi" Loti 1**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.11.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimet tuaja se komisioni ka vepruar në mënyrë selektive duke kërkuar vetëm nga ju që të dergoni sqarime lidhur me disa çmime jonormalisht të ulta janë plotësisht të bazuara, pasi që ato sqarime nuk janë kërkuar në baze të Rregullave për tenderet jonormalisht të ulët, respektivisht konstatimi për çmim të tenderit apo edhe për artikull-pozicion duhet të

bazohet ne keto Rregulla dhe ne formulen e caktuar ne te njejtat. Se keto kerkesa jane selektive deshmohet edhe me faktin se per disa pozicione qe jane kerkuar sqarime nga ju, tenderuesi i rekomanduar per kontrate ka çmime me te ulta dhe ne kete rast eshte dashte qe te gjithë tenderuesit te trajtohen njejte dhe te kerkohen sqarime edhe nga te tjeret. -


Bazuar ne keto pretendime te bazuara kerkoj qe aktiviteti te kthehet ne rivleresim dhe nese komisioni e sheh te arsyeshme te kerkoj sqarime per çmime jonormalisht te ulta apo per çfaredo aspekti tjeter duhet ti trajtoj ne menyre te barabarte te gjithë tenderuesit e pastaj te vendos per rekomandimin e vet per dhenje te kontrates.

Zyrtari nga Departamenti i prokurimit qe e administron kete aktivitet duhet te njoftoj lidhur me kete Njesine e kerkeses dhe te kerkoj propozimet per fazen e rivleresimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit